

PRIMO SHLLAKU

SE SI VEÇANTITË GJUHËSORE MUND TË KTHEHEN NË VEÇANTÏ POETIKE - RASTI I CAMAJT

Ardhja e papritun e Camajt në sheshin e letrave shqipe qe një befasim për të gjithë. Një palë u befasuen me verbin e tij të panjoftun dhe intrigues e enigmatik, një palë tjetër galduen prej shendit se një poet gegë po kthehej i kompletuem në tokën e vet amtare mbas një odiseje të dhimbshme për poetin si dhe për lexuesit e më vonë admiruesit e tij. Por befasimi nuk qe i vogël edhe për establishmentin letrar – shkrimtarë e kritikë bashkë – të cilët ishin msue me i ba hesapet pa Martinin, bile kundër Martinin. Ardhja e tij ishte ndoshta evenimenti që ndryshoi raportet mbrenda letrave shqipe në atë fillim ndryshimesh. Letërsia po e humbte karakterin e vet monist, ajo po lvizte për t’u strukturue simbas pohimeve të një gjithfarshmënie të mungueme e të anulhueme për vjete me radhë, me viktime të drejtëpërdrejta e të tërthorta, me asimilime rrafshuese talentesh e hovesh të qashtra parapolitike, me krijime pragjesh përjashtuese dhe demonizuese.

Ardhja e Martinin provokoi në heshtje krizën, krizën e vlerave, letrare dhe morale, krizën e hierarkive si dhe krizën shkrimtar-lexues. Edhe pse establishmenti letrar zyrtar e kishte kompaktsinë, të trashigueme këtë prej strukturash jashtalettrare e jashtaintelektuale, tronditja u ndie e fortë dhe e papërballueshme. Ndërsa botuesit dhe lexuesit vraponin mbas Martinin, shpesh pa e njoftë e, më shpesh, pa e kuptue, mendimi kritik letrar, ai që kemi, heshti tue zgjedhë nga arsenali i heshtjeve atë të heshtjes për rezervë. Dhe kur Martini po kthehej në mit – punë e keqe kjo ndër ne e me precedentë të denjë për harresë – u zgjodh si ekspedient adoptimi me shpejtsi i teorive strukturaliste të vjetëve ’60 – ’70. Kto teori ndër ne hynë me ngut dhe ksisoj prap u keqkuptuen dhe u keqtrajtuën. Nën pretekstin e modernizimit dhe përditsimit me ide të reja marrë nga Prendimi u arrit deri atje sa me krijue shpejt e shpejt një kult të strukturës dhe, si nëpër dhambë, me përçue idenë, sot shumë evidente dhe kambngulse, se letërsia mund të jetë vetëm estetikë e shkëputun prej çdo moraliteti. Kjo lvizje e shkathët dhe shumë inteligjente jo vetëm plotsonte një mungesë skandaloze të dijeve tona mbi letërsinë – punë fort e mirë kjo – por ajo adoptohej edhe me nijetin e amortizimit të efektit krizë që kishte shkaktue Martini.

Në shkrimet kritike gjithkund flitet për letërsi krahasimtare, kjo bile jepet edhe si landë në fakultete e në kurse të kualifikimit më të ultët, por askush prej kritikës zyrtare nuk i zbaton parimet e frymën e kësaj lande në shoshitjen e produktit letrar të pesëdhjetëçarit të dytë të shekullit të XX. Bile studiuesi i njoftun, Nasho Jorgaqi, deklaroi publikisht jo pa entuziazëm se letërsia e mbas vjetëve '90 nuk po ia kalon ende letërsisë së realizmit socialist. Për mendimin tim ky kritik e studiues ndër mend të tija, ose e ka përfshirë Martinin të realizmi socialist, ose ai nuk e njeh fare a, çka mund të jetë edhe më keq, e shpërnjef me qëllim. Për ta zhदारitë sadopak konfuzionin që sjellin të tilla pohime, më duhet të rrezikoj një pohim tjetër sa të vetëkuptueshëm aq edhe absolut se Martin Camaj nuk ka asnjë lidhje me realizmin socialist.

Megjithë promocionin e madh dhe librat që shkruhen për të, megjithë zbarkimin e tij total në Itakën e vet zezë, Uliksi Martin ende mbetet pa vend në hierarkinë e vlerave të letërsisë shqipe. Bile për nevojat e mbajtjes së më gjatë në ajër të kësaj "desanti" të kulturës e estetikës, është fshirë prej dekalogut të kritikës ideja e krahasimit mes individëve në bashkëkohsi, mes individëve në bashkëprofesion. Ky lloj agnosticizmi konservativ ka nevojë ta marrë vesht përsëritazi se baza e çdolloj njoftje është krahasimi dhe se kushdoqë nuk e përballon krahasimin, ka probleme me qenien e vet.

Puna e Martinit si *out-sider* në letrat shqipe është vetëm gegnishtja e tij e lidhun ngusht me një cilsi eprore të poetikës. Ardhja e Martinit në fillim të 1990-ës me cilsi të tij të poetikës e gjallninë imponuese të variantit të tij letrar, i bie objektivisht ndesh formulës letrare të Kongresit të Drejtshkrimit 1972. Ky kongres e përjashtoi gegnishten apriori dhe ndërtoi një formulë bashkëveprimi e cila nuk i la të hapuna membranat e përthithjes e sot, deri diku, ky standard ka shfaqur shënjë saturimi. Në anën tjetër duhet thanë se, edhe pse askund në materialet e kongresit nuk përshkruhej ndonjë përjashtim i gegnishtes, praktikat e mbaskongresit qenë krejt përjashtuese e deri denigruese. Ardhja e Martinit u përplas me një klimë përfundimi e fakti të kryhem, të bame jo prej vetë letërsisë e letrarëve, por prej gjuhtarëve të zellshëm, aq të zellshëm sa me djegë etapat dhe mos me respektue maturimin natyral të proceseve. Kongresi shpërnjofti me cinizëm Martin Camajn dhe, përveç tij, gjithë atë produkt inertial letrar që fshehtazi krijohej nën diktaturë por edhe vetvetishëm mbas vjetëve '90.

Çfarë do të bëhet pra me Martinin e mbaskongresit e me të tjerë shkrimtarë të koinesë geqe po të mbaskongresit? A do t'u hapet dera vlerave, nëse janë, apo *a priori* ata do të përjashtohen si të pabindun e "prishës të unitetit", siç tinzisht ka ndodhë deri më sot? Ç'vënd do të zanë

Se si veçantitë gjuhësore mund të kthehen në veçantí poetike...

ndër kurrikula kta autorë? Do të lëhen pa aparat gjuhsor e të paspjeguem në kontekstin e tyre nga fobia se po na kthehet gegnishtja, apo gegnishtja është ktu mbas shpinës tonë e, përderisa nuk duem ta shofim, ajo nuk ekziston?

Rasti vargnues e poezishkrues i Camajt na vërteton rolin konstitutiv të gjuhës në ngjizjen e poezisë. Veçantitë gjuhësore duhen për të krijuar veçanti poetike e anasjelltas. Kjo ka ndodhë shumë herë në letrat shqipe, por studimet tona i ndajnë me qëllim përjashtet gjuhësore ndër specimenët poetikë të cilisë së pazakontë. Mendojmë se atje ku nuk vepron tradita e madhe, e gjatë dhe “tiranike”, siç është përgjithsisht rasti i Martinit, vepron objektiviteti i rastit të veçantë, siç është prap rasti i Martinit. Ashtu siç thotë kolegja jonë Ledia Dushi, Martini e ktheu peizazhin e vorfën e të thatë bregut të Drinit në një univers të ndritshëm poetik. Fjala blatohet për të emnuar të veçantën jo konotative, por të veçantën e rrethanës emocionale dhe, për fat të keq të punës së respektueshme të gjuhtarëve, kjo fjalë ose nuk ekziston në fjalor, ose është e shenuar me remark përulës. Krezmin e jep harmonia poetike dhe ngarkesa naltuese humaniste. Parimet e tjera janë të shpikuna dhe me sferë të kufizuar veprimi. Nuk dëshiroj me prurje ktu para jush vargje, strofa e pasazhe të një natyre të fortë endemike, të papërkthyeshme edhe në gjuhët më të mëdha e, për pasojë, të patranskriptueshme në standard. Por shqetsimin se pse na pëlqen të jemi më të vorfën sesa jemi në realitet, besoj se duhet ta mbërrijë kjo konferencë për Martinin.

